

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 27.04.2023
PRIMLJENO:
Nr.No.Bi. 02 / 218



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Nr. 02/_____
Datë: 24.04.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -III- (tretë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e rregullt e mbajtur me datë: 20.03.2023.
- 2.Shqyrtimi i Raportit Financiar të Kryetarit për vitin 2022.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së KKSBB-së për vitin 2023.
- 4.Shqyrtimi i dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të luftës për vitin 2023.
- 5.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 20.03.2023 dhe filloi në ora: 10:40. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi,Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, Muharrem Morina, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Gentianë Hoti, Hamit Lima,Veton Zogaj, Sadik Vrenezi Arlindë Rudi, përfaqësuesi nga OSBE Salih Elshani dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -III- (tretë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi shtatë antarë, dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Kemi një pikë të rendit të ditës që ka ardhur nga zyra e kryetarit dhe propozoj që të futet në rend të ditës: kërkesa nr.01/1680 datë:05.10.2022, e parashtruar nga Burim Bytyqi nga fshati Kravasari. Kush është për, që kjo kërkesë të futet në rend të ditës?

Me vota unanime, kërkesa nr.01/1680 datë:05.10.2022 futet në rend të ditës.

Shkojmë në votim të rendit të ditës. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: shqyrtimim dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet procesverbali.

Kalojmë në pikën tjetër Shqyrtimi i Raportit Financiar të Kryetarit për vitin 2022. Për të prezantuar këtë pikë e kemi Drejtorin për Ekonomi dhe Financa. Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Duhet të ja filloj me falenderime duke filluar nga kryetari për përkrahje, mbështetje të realizimit të shpenzimeve të buxhetit vitin e kaluar, poashtu dhe asambleistët që janë një prej faktorët kyq që na kanë mbështet në realizimin e shpenzimeve të vitit 2022, poashtu dhe drejtorit përkatëse që është kërkar nga ta të jenë më aktiv për realizimin e shpenzimit.

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelat përkatëse del se Komuna e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin fiskal 2022, në shumën prej 15,655,757.00E për të gjitha programet dhe nën programet. Kur kësaj i shtohen bartjet e disa shumave të vogla të donacioneve të mbetura ga vitet e kaluara në shumën prej 1,140.35E të regjistruara në SIMFK, del se shuma totale e buxhetit është 15,656,897.35E. Kësaj shume i shtohen edhe shumat prej 640,429.28E nga të hyrat e bartura nga viti 2021, nga huamarrjet për paga në shëndetësi 92,883.00E dhe rritja e buxhetit për paga në arsim për mbulimin e vendimeve gjyqësore për 367,711.25, del si buxhet i tërsishëm i futur në SIMFK si buxhet aktual përfundimtar kap shumën prej 16,757,920.00E.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë, (Janar-dhjetor 2022) kap shumën prej 16,749,384.69 E, që do të thotë se shkalla e realizimit alokimi i buxhetit total është 99.95%.

Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar alokuar për periudhën janar-dhjetor 2022 është $16,705,105.04 / 16,749,384.69 \times 100 = 99.74\%$. Kurse përqindja e tërsishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është $16,705,105.04 / 16,757,920.88 \times 100 = 99.68\%$. Sipas buxhetit për vitin fiskal 2022, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mbledhen 1,033,469.00E. Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën janar-dhjetor 2022 është :të hyrat e rregullta 914,297.11E. Këto të hyra janë të futura në sistem, kurse janë alokuar shuma prej 1.033,469E, gjatë trafikut për janar dhjetor kapin shumën 250,001.00E, kurse gjatë gjykatave në këtë periudhë janë 21.60E. Pra, të hyrat e gjithëmbarshme, vetanake të realizuara për këtë periudhë kapin shumën 1,315,899.71E. Përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin është 127.33%, pra kemi një tejkalim prej 27.33%.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Ajo çka është me u përkrahë dhe që më ka gëzuar fakti për gjithë vitin, shihet një trend i rritjes të të hyrave vetanake, që e kanë përforcuar performancën e komunës në këtë aspekt.

Unë po ndalem te të hyrat vetanake ku në tabelë janë të cekura për secilën kategori të hyrat vetanake dhe krahasimi me vitin 2021. Po ndalem te disa që nuk mu kanë dukur në rregull, ose nuk janë regjistruar mirë, ose nuk ka pasur inkasim prej atyre kategorive. Te çertifikatat e kurorëzimit kemi një ngritje mbi një mijë euro. Te çertifikatat e lindjes në vitin 2022 kemi 200E, ndërsa në vitin 2021 nuk kemi fare të hyra, ndoshta janë të specifikara te çertifikatat e tjera.

Gjyqësori nga inspektoriat 2,698.92E, kjo shumë është jo korrekte duke filluar nga mirmbajtja e ambientit, prej operatorëve ekonomik, marketeve e gjitha bizneseve që vren shkelje dhe me qenë shuma 2.698 E është pak, dhe mendoj që duhet me u rrit performanca dukshëm në këtë fushë.

Qiraja për objekte- Unë së pari nuk e di sa objekte si qiradhënie i kemi si komunë dhe nuk e di cilat objekte hynë në këtë kategori.

Të hyrat nga viti i kaluar 3,800, çka nënkupton kjo, në cilën kategori mundemi me rendit?

Taksa për parkingun publik 210 E është ekstrem e pa përfillshme, sepse ai parking çdo herë ka qenë i mbushur.

Shfrytëzimi i pronës publike në këtë vit kemi 20.000E më shumë këtë vit, kjo përfshinë Pishinën e Banjës. Licenca tjera për afarizëm kemi përgjysmë më pak se vitin e kaluar, dmth këto janë bizneset afariste që regjistrohen në komunë.

Taksa për legalizim të objekteve e kemi zero, kjo është problematike sepse ne po e shohim qdo ditë që kemi ndërtime gjithë andej. Pranimi teknik I lokalit dhe këtu e kemi zero. Inspektimi higjienik sanitar 250E, dhe kjo është shqetësuese. Thertoret dhe ndërmarrjet që prodhojnë mish nuk e di a inspektohen ato. Të hyra nga agjensioni pyjor 21E është e ulët. Drejtoria e Bujqësisë duhet të merret urgjentisht me agjensionin pyjor ose me ja dhënë drynin atyre puntorëve.

Po kaloj te faqja 20 shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike janar dhjetor 2022.

Shpenzime udhëtimi brenda vendit janë 2.000,00E më shumë këtë vit sesa viti paraprak.

Shpenzime për internet dhe këtë është 3,000,00E më shumë sesa viti paraprak.

Shërbime të ndryshme intel në vitin 2021 ka qenë 9,580,00E, ndërsa në vitin 2022 35,680.00E, qfarë kategorie hynë ky shërbim sepse don shpjegim kjo.

Shërbime teknike 11,543.00E në vitin 2022 ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 1,143.00E.

Furnizim I zyreve është shumë e ngritur në vitin 2022 është 51,245.58E, kurse në vitin 2021 kanë qenë 29,583.56E.

Furnizim për pastrim në vitin 2022 kanë qenë 21,691.48 ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 14,743.85E. Këtu është cekur vaj, mirëpo nuk po e kuptoj qfarë vaji, sepse në viti 2022 kanë qenë 1,429.40 kurse në vitin 2021 kanë qenë 0E.

Te pjesa dru është dyfishim, mirëpo mundemi me kuptu për shkak të rritjes së qmimit.

Karburant për vetura është – në vitin 2022 është 77,939.09E ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 35,088.87 E.

Regjistër dhe sigurimi i automjete në vitin 2022 kanë qenë 25,885.46, ndërsa në vitin 2021 është 20,435.17.

Mirëmbajtja e ndërtesave në vitin 2022 janë 197,918.87, ndërsa në vitin 2021 janë 65,582.67E.

Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve në vitin 2021 kanë qenë 4,802.50 ndërsa në vitin 2022 janë 79,367.96E kjo shumë është shumë e madhe.

Shpenzime për informim publik në vitin 2022 kanë qenë 1,248.00 ndërsa në vitin 2021 janë 270E dhe e fundit dreka zyrtare dhe këtu kemi 10.000.00E më shumë në vitin 2021 kanë qenë 9,795.30 kurse në vitin 2022 janë 20,607.50E.

Argjend Thaçi: Faleminderit Veton! Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket këti Raporti po shihet që komuna e Malishevës e ka pasur një progres shumë të madh në alokimin e këtyre të hyrave dhe janë grumbulluar të gjitha ato që janë planifikuar të grumbullohen.

Argjend Thaçi: Urdhro, drejtor!

Blerim Thaçi: Ne jemi për realizimin e shpenzimit mbi bazën e dokumentacionit që na ofron zyra dhe drejtoria e bujqësisë e ka bërë planifikimin e shpenzimit për subvencione i ka llogaritur të gjitha brenda drejtorisë, qoftë për sera, blektori. Është mirë me qenë dhe drejtori me ba një planifikim, sepse ka procedurë që është zhvilluar dhe ne hymë në obligime ndaj operatorëve dhe këto vendime që i merrni ju ne duhet me i marr prej asaj drejtorie.

Unë do lidhem te fjalimi i Vetonit, te qështja e qirave të objekteve dhe shfrytëzimi i pronës publike te qështja e qirave për objekte dhe shfrytëzimi i pronës publike. Është qështja e pishinës së Banjës, mirëpo ka dhe objekte tjera që kanë obligime që krijojnë të hyra në Kuvendin komunal mbi bazën e asaj që e shfrytëzojnë. Licencat tjera për afarizëm, nuk ka pasur subjekte afariste që kanë kërkuar licenca. Taksa për legalizime të objekteve, procedura e legalizimit të objekteve që kanë qenë të ndërtuara nuk e di a kanë kërkuar ndokush me legalizu objektin.

Veton Zogaj: Nuk mundet ai me fillu me vendos banorë, me ju shit banesat nëse nuk e ka legalizimin.

Blerim Thaçi: Kjo është taks për legalizimin e objekteve të ndërtuara. Te pranimit teknik i lokaleve nuk e di a ka pasur kërkesa, kjo është qështje e urbanizimit se a ka pasur kërkesa apo jo.

Pajtohem me të hyrat e Agjensionit pyjor, i cili nuk ka realizuar e në realitet mundet me qenë ndryshe nga ajo që e the.

Te pjesa e dytë te shpenzimet janë faktor të ndryshëm mbi bazën e realizimit të shpenzimit , ndërsa vitet e tjera nuk janë realizuar shpenzimet. Tani është shpenzimi më i lartë dhe e rrit dhe vlerën e shpenzimeve të mjeteve. Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit këtu është rritur qind për qind dhe kjo është justifikuar ai shpenzim se pse është bërë.

Te shpenzimet për internet ju e dini që dhe qmimet e internetit janë rrit, mirëpo duhet të keni parasysh që kemi pasur obligim dhe të vitit të kalum dhe kur grumbullohen ato duhet të kryhen si obligime.

Shërbime të ndryshme intel janë një kategori e mallra shërbime intelektuale për mirëqenie është si kategori e veqantë që e ndajnë.

Furnizimi me zyre- nevoja për këtë furnizim është më shumë i nevojshëm mirëpo nuk është shpenzuar sa është nevoja për furnizim me zyre.

Vaj –është në kuadër të derivative. Karburante dihet që ka qenë dhe rritja e qmimit dhe përveq qmimit këtu hynë dhe shpenzimet që realizohen gjatë dimrit më shumë nëpër shkolla kur ka munges të energjisë dhe duhet të përdoren degjeneratorit.

Regjistrimi për vetura nuk është qështje që varet nga ne është taks strikte dhe qdo operator që e kryjnë është e njejtë.

Te mirëmbajtja e ndërtesave mund të hynë dhe mirëmbajtja e realizimit të nxemjeve nëpër shkolla që është dashur renovim dhe me i furnizu me kalldaja.

Mirëmbajtja e paisjeve mobileve dhe kjo është qështje furnizime me mobile dhe mirëmbajtje.

Dreka zyrtare është dhe si pasoj e aktiviteteve që janë shtuar dhe në kuadër të kësaj është dyfishuar shpenzimi.

Argjend Thaçi: Kush është për që Raportit Financiar të Kryetarit për vitin 2022, të rekomandohet për kuvend.

Unanimisht kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2023. Kordinatori Halit Mazreku është në pushim vjetor dhe nuk mund të merr pjesë në mbledhje. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ky komision është i rëndësishëm dhe sa e pash në këtë planifikimin që e kanë bërë më shumë na kanë dhënë sqarime mbi termat qka është MAPL-ja,OJQ-ja dhe komplet planifikimin e orientojnë në këso terma dhe për mendimin tim janë shumë të panevojshme, ndërsa planifikim çka do të bëjnë i kanë dy faqe.

Argjend Thaçi: Kush është për që Plani vjetor të punës së KKS-së për vitin 2023 të rekomandohet për kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën e 4 Planit të punës të Komitetit për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të luftës për vitin 2023.

Veton Zogaj: Po vrej dhe te ky komitet, por dhe te komitetet tjera po shkojnë copy paste, nuk po dalin përtej asaj, sepse janë disa aktivitete që duhet të dilet përtej tyre.

Argjend Thaçi: Ka pak tejkalim të kompetencave e atyre që i kanë si komitete. Kanë kërkuar 50,000.00E për renovimin e Muzeut të varrezave të dëshmorëve dhe memorialeve. Ne mundemi me voto Planin dhe kur të na vjen një kërkesë e tillë ne e shqyrtojm. Kush është për miratimin e Planit të punës të Komitetit për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të luftës për vitin 2023 ti rekomandohet Kuvendit? Me

vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën e ardhur nga zyra e kryetarit : kërkesa nr.01/1680 datë:05.10.2022, e parashtruar nga Burim Bytyqi nga fshati Kravasari për djegien e stallës së bagëtive.

Veton Zogaj: Mirë që e ka sjellë kryetari, mirëpo me këtë po krijohet standarte të dyfishta. Para dy-tre muajsh e kemi pasur një kërkesë të natyrës së njejtë nga kolegja dhe e ka tërhequr. Ky zotëria para se të na sjellë neve kërkesën është dashur të lypet shkaktari se kush e ka shkaktuar zjarrin, sepse nëse është nga KEDS-i duhet me e padit KEDS-in, ose nga fatkeqësit natyrore, e nëse është nga pakujdesia e punëtorit duhet me e drejtu në Gjykatë. Janë një sërë qështjesh që duhet me ju drejtu, para se me ju drejtu Kuvendit. Ne mundemi me e rekomandu Kuvendit dhe e diskutojm aty.

Argjend Thaçi: Kush është për, kërkesa nr.01/1680 datë:05.10.2022, e parashtruar nga Burim Bytyqi nga fshati Kravasari për djegien e stallës së bagëtive të rekomandohet për Kuvend?

Për: 6

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 6 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kemi kërkuar dhe në Kuvend dhe po e kërkoj prapë dhe këtu Planin e Prokurimit.

Argjend Thaçi: Planin e Prokurimit e kemi në muajin prill. Kalojmë te shqyrtimi i kërkesave. Kërkesë nga Bekim Krasniqi është pronar posedues i palushmërisë sipas lëndës 1269/2, në vendin e quajtur Rreze zona kadastrale Tërpezë, komuna e Malishevës është pronare e pasurisë sipas lëndës dhe duke pasur parasysh se këto prona janë fqinje me njëra tjetrën pala Bekim Krasniqi gjatë punimit të ngastrës së tij ai dhe parardhësit të tij ka mundur të vijë deri te humbja e sinoreve dhe pse pala këtë nuk ka mundur ta dijë saktë.

Në gusht të vitit 2022 pala ndërton shtëpien e banimit në ngastrën e tij dhe të njejtën e

përfundon, por kohën e fundit pas inspektimit të pronës dhe shikimit të saj kemi vërejtur që një pjesë e shtëpisë tonë ka dalur të jetë në ngastrën e komunës së Malishevës. Ky gabim ka ndodhur për shkak të konfiguracionit të pronave, sepse janë fqinje me njëra tjetrën dhe nuk kanë qenë të vendosura sinoret në mes tyre. Duke pasur parasysh se unë jam fqinje me ju atëherë jap pelqim që të bëhet ndërrimi i ngastrave, të pjesës të sipërfaqeve të tyre që e përcakton eksperti i gjeodezisë. Pra, kemi një kërkesë për këmbim të pronave.

Veton Zogaj: E di ku është kjo pronë dhe këtë kërkesë nuk e kisha dërguar në Kuvend, para se me dërgu në Gjeodezi dhe Kadastër, sepse ky e ka një objekt të ndërtuar në ballë të rrugës "Adem Jashari", rrugës që shkon për Prishtinë. Me çka po don me kompenzu, sepse nëse është prona e komunës pas objektit, realisht komuna nuk ka lëvërdi me ja dhënë pronën me kompenzu. Unë e kisha dërguar në Gjeodezi dhe Kadastër që të dalin në teren dhe ta vlerësojnë.

Argjend Thaçi: Po e shtyjmë për mbledhjen tjetër. Kush është për që kjo kërkesë të shtyhet? Me vota unanime, kjo kërkesë shtyhet për mbledhjen tjetër.

Kërkesa tjetër është nga Mehmet Morina nga fshati Drenoc kërkon ndihmë për vajzën për vizita shëndetësore, mirëpo e njejta merr pagë 375E në muaj për personat me aftësi të kufizuar. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare ne po e refuzojm. Kush është për refuzimin e kërkesës për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Unanimisht, kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nr.02/529 datë:04.11.2022 nga Mihrije Halitaj për ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Kush është që kjo kërkesë të refuzohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare?

Unanimisht, kjo kërkesë refuzohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Veton Zogaj: Uroj që kjo punë nuk do të keqpërdoret.

Argjend Thaçi: Kërkesa tjetër është nr.02/32 datë:19.01.2023 e parashtruar nga Shyhrete Gashti. Kush është që kjo kërkesë të refuzohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Me vota unanime, kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nr.02/96 datë: 21.02.2023. Kush është që kjo kërkesë të refuzohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Unanimisht, kjo kërkesë refuzohet për mungesë të mjeteve financiare.

Kërkesa tjetër është Sabit Muhaxheri në moshë 89 vjeçar për shkak të rrëzimit ka thyer këmbën. Këtë kërkesë po e rekomandojmë te zyra e kryetarit, kush është për?

Për: 6

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kërkesa tjetër është Urim Sahitaj kërkon ndihmë financiare për motrën Fetije Sahitaj, këtë po e dërgojmë te kryetari. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet te kryetari?
Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet te zyra e kryetarit.

Kërkesa tjetër është nga Gazmend Krasniqi kërkon ndihmë për vajzën e sëmurë dhe shërimi po i kushton dhe nuk kam mundësi të i paguaj shpresoj në ndihmën tuaj.

Sadik Vrenezi: Gjendjen e ka të keqe vetëm hapat 600E prej Amerike ja sjellin.

Argjend Thaçi: Këtë kërkesë po e rekomandojmë te zyra e kryetarit. Kush është për?
Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet te zyra e kryetarit.

Kërkesa tjetër është nga Kadri Bytyqi për ndihmë financiare të vajzës së tij e cila vuan nga një sëmundje e familjes së leukemis. Kësaj kërkesë po ja ndajm 500E. Kush është për?
Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është nga Defrim Lima që nga lindja vuan nga probleme shëndetësore dhe që dy vite më është ndalur dhe social. Kush është që kësaj kërkesë t'i ndahen 450E?
Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 450E.

Kërkesa tjetër është nga Ragip Berisha, i cili ka probleme shëndetësore, është në moshë të shtyer, rast social dhe i pa punë.

Veton Zogaj: Kjo kërkesë është pak e ngjajshme me kërkesën që e rekomanduam te kryetari dhe ai ishte në moshë të shtyer. Kryesues mos krijo standarte të dyfishta.

Argjend Thaçi: Kush është për që kësaj kërkesë Ragip Berisha ti ndahen 350E?
Me 6 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim kësaj kërkesë i ndahen 350E.

Kërkesa tjetër është 02/96 nga Edison Zulfaj i cili kërkon ndihmë financiare për shkak të lëndimit gjatë orarit të punës. Kush është për që kjo kërkesë të refuzohet?
Unanimisht, kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nga Sabrije Zogaj Bellanicë. Kush është që kjo kërkesë të refuzohet? Me vota unanime, kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është 02/81. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?
Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është Shukrie Gashi me sëmundjen e kancerit. Po e rekomandojmë për Kuvend.
Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për kuvend.

Kërkesa tjetër është Rrahime Kryeziu me sëmundjen e kancerit. Kush është për, që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?
Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është Latife Krasniqi me sëmundjen e tumorit. Kush është për që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga dy Deputetët e Republikës së Kosovës Jetmire Vrenezi dhe Gani Krasniqi, të cilët kërkojnë një zyrë ku do të ketë një vendtakim për qytetarët e interesuar për të shprehur hallet, brengat, kërkesat por dhe vërejtjet e tyre. Poashtu kjo zyre të shërbej dhe si zyre kordinuese në mes deputetëve dhe komunës për të ngritur qështje me interes për qytetarët e komunës së Malishevës në nivelin qendror. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kjo kërkesë është nga dy deputetët e VV-së. Kjo kërkesë ka qenë dhe më herët dhe nuk e di a është shqyrtuar nga kuvendi paraprak. Ka bazë të arsyeshme plotesisht, sepse e patëm rastin kur kishim probleme me energji elektrike, dhe pastaj ishte si një lloj lufte në mes pushtetit lokal dhe nivelit qendror se a kam ngrit apo jo qështje. Praktikë është e të gjitha komunave kjo që kryetari e ndan një hapsirë publike për deputetët pa dallime. Unë mendoj që kjo kërkesë të dërgohet në Kuvend.

Argjend Thaçi: Kjo kërkesë nuk e di pse ka ardhur te ne, sepse kuvendi nuk ndan zyre. Kjo kërkesë duhet të shkojë ose te drejtori i administratës ose te kryetari.

Veton Zogaj: Si kërkesë duhet të trajtohet në Kuvend.

Hamit Lima: Më mirë të i drejtohet drejtorit të administratës dhe kryetarit, ata e dinë cila hapsirë është e lirë dhe pastaj ata mundën me sjellë në kuvend që kjo zyre është e lirë dhe ju lejohet deputetëve të Republikës.

Rukije Bytyqi: Unë sa e di nuk ka zyre.

Argjend Thaçi: Kush është që kërkesa 02/11 të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Faleminderit për pjesmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora: 12:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

